



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **19.1.2024**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje nënkryetar **Fatmir Iska**. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm! Faleminderit shumë për pjesëmarrjen! E hapim mbledhjen e parë (1) të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale, P-02343-0 me pronën e institucionit qendror, P-01422-5, zk - Rahovec;
3. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale, P-02280-1 me pronën e institucionit qendror, P- 02240-1 zk - Rahovec;
4. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023-2031;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi: A kemi ndonjë pikë shtesë nga anëtarët e KPF-së? Nëse jo, atëherë kalojmë në votim. Kush është “për” këtë rend dite?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash, aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A kemi ndonjë diskutim, vërejtje apo koment rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash votohet pika e parë.

2. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale, P-02343-0 me pronën e institucionit qendror, P-01422-5, zk – Rahovec:

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së. Bëhet fjalë për një propozim për marrjen e pëlqimit për këmbimin e pronës në zonën kadastrale në Rahovec, konkretisht për një parcelë e cila gjendet para parcelave ku është duke u ndërtuar Sheshi Qendror i qytetit. Është pronë e Agjencionit të Ujërave. Bëhet fjalë për 132m², t’ua marrim atyre dhe t’i japim pronë komunale në sipërfaqe të njëjtë, e cila gjendet në zonë kadastrale në Rahovec, P-1422-5, në rrugën Rahovec – Malishevë, te pompa “Teuta”.

Kryesuesi: A kemi ndonjë diskutim lidhur me këtë pikë? Nëse jo, atëherë kalojmë në votim, kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale, P-02280-1 me pronën e institucionit qendror, P- 02240-1, zk – Rahovec:

Afrim Oruqi: Sipas ligjeve në fuqi, kryetari i Komunës ju propozon që të merrni pëlqim për këmbimin e pronës komunale me pronën e institucionit qendror (Agjencionit Pyjor të Kosovës). Bëhet fjalë për parcelën në dalje të Rahovecit në anën e djathtë (mbi rrugën e transitit). Sipërfaqja e këtij propozimi për këmbim është 3 ha për interesa dhe nevoja të komunës dhe të bizneseve të komunës. Agjencionit Pyjor t’ia japim në këmbim pronën e komunës me nr. 2240-1, e cila gjendet afër rrugës Rahovec – Drenoc, konkretisht afër deponisë legale të mbeturinave. Qëllimi i këtij këmbimi ka të bëjë me projektet zhvillimore të komunës.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A kemi ndonjë diskutim lidhur me këtë pikë? Nëse jo, atëherë kalojmë në votim, kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit:

Skender Hamza: Përshëndetje, kryesues, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të komitetit, kolegë të pranishëm. Në mungesë të drejtoreshës Saranda Sallteku, do ta prezantoj një raport të anëtarëve të Komitetit për Persona me Aftësi të kufizuara, sepse kam qenë me ta rregullisht gjatë gjithë këtij procesi. Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ 01/2016 për procedurat e themelimit dhe të organizimit të komiteteve konsultative, Statutit të Komunës, vendimit të Komunës së Rahovecit, të datës 31.7.2023 dhe shpalljes së konkursit, të datës 4.12.2023, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin e takimit lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. Komisioni ka dalë nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit më datë 31.7.2023. Anëtarët e komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e anëtarëve të komitetit në fjalë, janë: Sinan Kryeziu, Melinda Iska, Vlora Vuçiterna, Saranda Sallteku dhe Valentina Krasniqi. Ky konkurs, në mungesë të kandidatëve të interesuar, ka dështuar dy herë. Pas rishpalljes së tretë të këtij konkursi, kemi pasur kandidatë të interesuar për këtë komitet dhe janë gjithsej 6 kandidatë. Komisioni për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, më datë 15.1.2024, ka mbajtur takimin e tyre. Në takim, komisioni ka bërë hapjen e dosjeve dhe pas vlerësimit të dosjeve, komisioni ka pasur detyrë që nga 6 aplikantë, të përzgjedhë 5 prej tyre. Pas shqyrtimit të dosjeve, komisioni, në mënyrë unanime, ka vendosur që këta 5 aplikues të jenë pjesë e komitetit: Atdhe Rama -master i financave, Elmedina Jaha – bachelor e psikologjisë, Samra Kërqagu - bachelor e psikologjisë, Altina Mezini – bachelor e punëve sociale dhe Selman Shtavica – ud i drejtorisë së shoqatës “Handi-Kos” – Rahovec.

Kryesuesi: Faleminderit, Skender! A kemi ndonjë diskutim lidhur me këtë pikë? Nëse jo, atëherë kalojmë në votim me përbërjen e komitetit, ashtu siç e ceku Skender Hamza, kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023-2031:

Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së. Arsyeja që ka ardhur përsëri si kërkesë për miratim është neni 3, i cili ka qenë në vendimin e parë e në këtë të dytin duhet të hiqet. Në nenin 3 thuhet: Të gjitha planet do të mbesin në fuqi deri në miratimin e Hartës Zonale. Zyra Ligjore e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka kërkuar që ky nen të hiqet nga vendimi, ndërsa ne, gjatë marrjes së pëlqimit për PZhK nga ministria e njëjtë, është cekur që me Plan Zhvillimor Komunal nuk mund të lëshojmë leje, sepse me planin aktual që e kemi nuk mund të lëshojmë leje deri në miratimin e Hartës Zonale. Kjo do të thotë që të gjitha planet që kanë qenë, nuk janë në kundërshtim

me PZhK-në. Kërkesë e Departamentit Ligjor në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është që neni 3 të tërhiqet dhe duhet të vazhdojmë për miratim në Kuvend Komunal.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, anëtarë të KPF-së. Një pyetje e kam: A keni diskutuar prapë me ata se për çfarë arsye është ky nen aty, apo tani janë të vetëdijshëm që pas plotësimit ndryshimit që do ta bëjmë në Kuvend, që Komuna nuk do të jetë në gjendje të japë leje deri sa të përfundojë Harta Zonale. A kanë dhënë argument se pse duhet ta largojmë patjetër?

Albnor Mullabazi: Gjatë javës së kaluar kam qenë në takim në departamentin ligjor të ministrisë, me zyrtarët të cilët kanë marrë vendimin. Te ata është që me Plan Zhvillimor, mund të jepen lejet, ndërsa te departamenti i planifikimit, që është brenda të njëjtës ministri thotë që me PZhK nuk mund të lëshohen lejet. Dy departamente brenda ministrisë janë me vendime të kundërta.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A kemi ndonjë diskutim tjetër rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

6. Të ndryshme:

Defrim Kafexhiu: Faleminderit! E kam një pyetje dhe një kërkesë për në seancën e rregullt, prej drejtorit për Gjeodezi dhe Kadastër. Drejtor, e kemi diskutuar dhe të kam pyetur për çështjen e trafos elektrike për Lagjen e Epërme dhe për parcelën e komunës që është afër xhamisë. A është e mundur që për seancën e rregullt, drejtoria juaj të na tregojë një skicë se ku është sipërfaqja e nevojshme për një trafo. Më tutje, të bëhet kërkesa në KEDS nëse i plotëson kushtet për vendosjen e trafos, nëse jo, cila është mënyra që ta shtyjme tutje këtë kërkesë të banorëve të asaj lagjeje?...

Kryesuesi: Faleminderit, Defrim Kafexhiu! Lidhur me pyetjen, drejtori do t’ju përgjigjet me shkresë. Nëse dikush tjetër nuk ka ndonjë gjë, dua t’ju informoj se në seancën e rregullt të kuvendit, si pikë të tjera do të jenë:

Raporti Financiar janar – dhjetor 2023;

Informatë mbi realizimin e planit të veprimit për Transparencë Komunale 2023;

Raporti vjetor i punës i Komitetit për Komunitete 2023;

Raporti i Performancës Komunale 2022;

Informatë rreth aktiviteteve të KKS-së 2023;

Raporti vjetor i punës i këshillit të fshatit Hoçë e Madhe 2023;

Raporti vjetor i punës i Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale 2023;


Plotësim-ndryshimi i vendimit të planit të punës së të këshillit të Hoçës së Madhe;

Këto pika që i lexova, do të jenë në mbledhjen e rregullt të kuvendit si pika të rregullta. A keni ndonjë gjë shtesë? Nëse jo, atëherë e quajmë të mbyllur mbledhjen e parë të KPF-së për 2024, faleminderit!

Mbledhja përfundoi: 10:30

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi

 **KRYESUESI**

Arbër Zenuni